



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA MALLAKASTËR  
KRYETARI

Nr. \_\_\_\_\_ Regj.  
2020

Ballsh, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ .

Lënda: **Dërgohet për publikim në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe Buletinin e Njoftimeve Publike, Formulari i Njoftimit të Fituesit**

**AGJENCISË SË PROKURIMIT PUBLIK – TIRANË (SPE)**

për ngarkim në sistemin e prokurimit elektronik të APP, në adresën [www.app.gov.al](http://www.app.gov.al)

---

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT**  
**BASHKIA MALLAKASTËR**

Data 20.07.2020

Për: **Operatorin Ekonomik “SHENDELLI” shpk, me NIPT K07924803N, me adresë Lagjja “Kastrioti”, Rruga “Andon Profka”, 2 kullat, Fier.**

\* \* \*

Procedura e prokurimit: **“E hapur”**

Numri i references së procedurës: **REF-59248-05-28-2020**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Materiale të ndryshme, çakull, stabilizant, rërë bituminoze për mirëmbajtje rruge në fshatra” (për nevoja të NSHP), me fond limit **33’333’333** (tridhjetë e tremilion e treqind e tridhjetë e tremijë e treqind e tridhjetë e tre) **lekë pa TVSH**, me afat 3 muaj.

Publikime të mëparshme: Buletini i Njoftimeve Publike nr.32, datë 01 qershor 2020

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X** oferta ekonomikisht më e favorshme

**Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:**

**1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “BRAHAJ” shpk, me NIPT K37513881M & “HEKO KONSTRUKSION” shpk, me NIPT L13328401P, ka paraqitur ofertën ekonomike**

në shumën prej **32,072,540** (tridhjetë e dymilion e shtatëdhjetë e dymijë e pesëqind e dyzetë) **lekë pa TVSH.**

- 2. Operatori Ekonomik “SHENDELLI” shpk, me NIPT K07924803N, ka paraqitur ofertën ekonomike në shumën prej 29,832,000 (njëzetë e nëntë milion e tetëqind e tridhjetë e dy) lekë pa TVSH.**

**Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

- 1. Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë “BRAHAJ” shpk, me NIPT K37513881M & “HEKO KONSTRUKSION” shpk, me NIPT L13328401P, për arsye se nuk plotëson të gjitha kërkesat për kualifikim, sipas përcaktimeve të bëra në dokumentat e tenderit, pasi ka këto mangësi në dokumentacionin e paraqitur:**

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “HEKO KONSTRUKSION” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.2.1. e kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore lidhur me xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore të operatorit ekonomik (2017, 2018, 2019).

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “BRAHAJ” shpk & “HEKO KONSTRUKSION” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “HEKO KONSTRUKSION” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.2.3. e kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, pasi nuk është paraqitur kopje e çertifikuar e bilancit të vitit 2018. Gjithashtu bilancet e viteve 2016 dhe 2017 janë të pakonfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “BRAHAJ” shpk & “HEKO KONSTRUKSION” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “HEKO KONSTRUKSION” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.2.3. e kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, pasi referuar dokumentit të ngarkuar në sistem “Vërtetim Debie...” ne.416 prot, datë 28.05.2020 lëshuar nga FSHU (OSHEE GROUP), rezulton se ky dokument nuk është paraqitur në formën e kërkuar në dokumentat e tenderi “origjinal ose kopje e noterizuar”, por është paraqitur fotokopje.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “BRAHAJ” shpk & “HEKO KONSTRUKSION” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga njëri prej anëtarëve të BOE, konkretisht “HEKO KONSTRUKSION” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.2.4. e kapacitetit ekonomik dhe financiar, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, pasi referuar dokumentit të ngarkuar në sistem “Vërtetim” ne.609 prot, datë 01.10.2019 lëshuar nga Bashkia Fier, rezulton se ky dokument nuk është paraqitur në formën e kërkuar në dokumentat e tenderi “origjinal ose kopje e noterizuar”, por është paraqitur fotokopje.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “BRAHAJ” shpk & “HEKO KONSTRUKSION” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga anëtari lider i BOE, konkretisht “BRAHAJ” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.1. e kapacitetit teknik, te Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të

dokumentave standarte të tenderit, lidhur me punët e ngjashme të mëparshme, pasi kontrata e furnizimit e prezantuar si e realizuar me sektorin privat, nuk është shoqëruar me faturat tatimore të shitjes.

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “BRAHAJ” shpk & “HEKO KONSTRUKSION” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

- Nga BOE “BRAHAJ” shpk & “HEKO KONSTRUKSION” shpk, nuk plotësohet kërkesa e përcaktuar në pikën 2.3.7. e kapacitetit teknik, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, në Shtojcën 9 të dokumentave standarte të tenderit, lidhur me numrin e kamionëve të kërkuar, pasi referuar dokumentacionit të paraqitur rezulton se: - për kamionin me targë AA352DN çertifikata e kontrollit teknik (SGS) dhe polica e sigurimit të detyrueshëm (siguracioni) kanë humbur afatin e vlefshmërisë; - për kamionin (gjysem rimorkio) me targë AER398 nuk është paraqitur çertifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse; - për kamionin me targë AA615MP nuk është paraqitur çertifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse; - për kamionin me targë AA483LH çertifikata e transportit të mallrave të lëshuar nga bashkia përkatëse ka humbur afatin e vlefshmërisë;

*Rrjedhimisht, referuar sa më sipër nga Bashkimi i Operatorëve Ekonomikë (BOE) “BRAHAJ” shpk & “HEKO KONSTRUKSION” shpk nuk plotësohet kjo kërkesë.*

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin Ekonomik “SHENDELLI” shpk, me NIPT K07924803N, me adresë Lagjja “Kastrioti”, Rruga “Andon Profka”, 2 kullat Fier**, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **29,832,000** (njëzetë e nëntë milion e tetëqind e tridhjetë e dy) **lekë pa TVSH**, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë Mallakastër lagjia “18 Prilli”, Ballsh, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të veprohet siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 10.07.2020

Ankesa: Nuk ka patur ankesa.

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR**

**Qerim Ismailaj**